



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:164314

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05785656

C.nr. 621/20

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË - departamenti i përgjithshëm – divizioni civil me gjyqtar Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit KEDS Distrikti në P, e autorizuar G.H, kundër të paditurit L. I. V nga fsh. S, me padi për kompensim të dëmit material, pas mbajtjes së seancës të datë 28.05.2024, mori, ndërsa me date 05.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M
-Për shkak të mungesës-

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses KEDS Distrikti në P.

II. Obligohet i padituri L. V nga fsh. S, që paditësit KEDS Distrikti në P, ti kompensoi shumën prej 379.21 € me kamat vjetore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit, e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës taksen gjyqësore në shumë 20€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi KEDS në P, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit L. I. V nga fsh. S, për kompensim të dëmit në vlerë 379.21 €.

Gjykata ka caktuar seancë me datën 28.05.2024, në seancë ka prezantuar vetëm e autorizuar e paditësit G. H, e cila ka kërkuar nxjerrjen e aktgjykimit në bazë të mungesës.

Gjykata të paditurit ia ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi me datën 18.01.2022 të cilit ia ka bashkangjitur padinë dhe provat materiale dhe atë: aktgjykimin P.nr. 335/19 të dt. 22.10.2020, fatura për kalkulimin e demit të shkaktuar në KW.nr. 248091 të dt. 24.05.2019, fatura e demit DPZHP1914253 të dt. 27.05.2019, procesverbali me nr. 2290793 dhe foto dokumentacioni nga të cilat vërtetohet vlera e demit dhe fakti se i padituri nuk ka kontestuar këtë dem.

Gjykata në seancë gjyqësore ka gjetur se: I padituri brenda afatin ligjor prej 15 ditësh nuk ka parashtruar përgjigje në padi, nuk ka kontestuar kërkesëpadinë, nuk është përgjegjës ftesës për seancë, themelësia e kërkesë padisë del nga provat e bashkangjitura padisë, faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga paditësi.

Andaj gjykata duke u bazuar në Nenin 151 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mori duke u bazuar në Nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:164314 të dt. 05.06.2024**

G j y q t a r i

Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.